



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 299

Datë: 15.06.2022

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (a,d), paragrafi 3, nenit 17, nenit 40 paragrafi shkronja (a), nenit 58 shkronja (h), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008", bazuar në nenin 13, nenin 47, të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë: 12.11.2008, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, me datë: 13.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIMIN DDHE PLOTESIMIN E STATUTIT TË
KOMUNËS SË MALISHEVËS

1. Miratohet kërkesa Nr.01/819 datë: 26.05.2022 e parashtruar nga kryetari i Komunës së Malishevës, për formimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Malishevës.
2. Mbështetur në nenin 1 të këtij vendimi komisioni do të jetë në përbërje prej 9 (nëntë) anëtarëve si në vijim;
 - 2.1. Argjend Thaçi, Kryesuesi i Kuvendit - anëtar
 - 2.2. Vesel Krasniqi, Nënkryetar i Komunës - anëtar
 - 2.3. Fatmir Ademaj, Drejtori i Drejtorisë për Administratë të përgjithshme - anëtar
 - 2.4. Valon Mazreku, Nisma Socialdemokrate - anëtar
 - 2.5. Mirëllinda Gashi, PDK - anëtare
 - 2.6. Labinot Gashi, LDK - anëtar
 - 2.7. Veton Zogaj, VV - anëtar
 - 2.8. Eqrem Morina, AAK - anëtar
 - 2.9. Elmi Krasniqi nga shoqëria civile - anëtar
3. Komisioni me përbërjen e lartcekur ka për obligim të bëjë ndryshimet në Statutin e Komunës konform Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe ligjeve tjera në Republikën e Kosovës.
4. Pas ndryshimit të Statutit si akt më i lartë juridik i Komunës, i njëjti do të ju nënshtrohet procedurave ligjore në Kuvendin Komunal dhe diskutimit publik sipas ligjeve në fuqi.
5. Kryesuesi i Komisionit zgjidhet me konsensus të brendshëm të anëtarëve të Komisionit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Kuvendit.
7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës.

Vendimi ju dërgohet:

Arkivit të Komunës

MAPL-së.





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNË E MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVE



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVË

PRIMLJENO:

Nr./No.Rr:

26/05/2022

01/819

Kryetari i Komunës

Nr. 01/

Datë: 24/05/2022

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës
Kryesuesit z. Argjend Thaçi.

Datë: 24.05.2022

Kopje: Arkivit të komunës

Lënda: Propozim për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Malishevës.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës, Ligji nr.03/L-040, neni 12 paragrafi 12.3, Statutin e Komunës së Malishevës, neni 13 par.13.1 shkronja (a) propozojë për shqyrtim para jush, iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Malishevës.

Procedura për propozimet e reja për ndryshime dhe plotësime, të Statutit të Komunës së Malishevës, bëhet ngase Statuti i vjetër është miratuar me datë 12.11.2008, dhe nga ajo kohë, nuk kemi pasur asnjë ndryshim, ndërsa legjislacioni që e rregullon qeverisjen lokale ka pësuar ndryshime dhe si rezultat i tyre është e domosdoshme që edhe Statuti i Komunës së Malishevës, të jetë në harmoni me këto ndryshime ligjore.

Shpresojë që së bashku me Ju, do të arrijmë të harmonizojmë kërkesat ligjore me Statutin e Komunës së Malishevës, në mënyrë që i njëjti të jetë në harmoni me ligjin, por edhe me praktikën e reja në qeverisjen lokale.

Propozimet për ndryshime dhe plotësime, do të paraqitën së pari në Komitetin për Politikë dhe Financa, konform dispozitave të parapara me nenin 13 par.13.2, të Statutit të Komunës së Malishevës dhe pastaj do të kalojnë në Kuvendin e Komunës për fazën e parë, përkatësisht vendimin preliminarë.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Me respekt,

